

## **URDHËR I PËRBASHKËT**

**Nr. 75, datë 2.6.2023**

### **PËR MBLEDHJEN, PËRPUNIMIN, EVIDENTIMIN DHE FSHIRJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR TË HUAJT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 137, pika 2, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”,

#### **URDHËROJMË:**

1. Të dhënat personale të shtetasve të huaj, të cilët janë pajisur me vizë, me leje qëndrimi, leje unike ose rezultojnë të parregullt në Republikën e Shqipërisë, mbledhen dhe administrohen nga autoritetet shtetërore përgjegjëse për trajtimin e të huajve si vijon:

- Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe drejtoritë vendore për kufirin dhe migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive/drejtoritë rajonale të AKPA-s, Ministria për Financat dhe Ekonominë;

- Drejtoria e Çështjeve Konsullore, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

2. Autoritetet përgjegjëse shtetërore mbledhin dhe administrojnë nga organet shtetërore, subjektet private, shtetas shqiptarë apo të huaj, të dhëna personale për të huajt vetëm në funksion të procedurave të pajisjes me vizë, pajisjes me leje qëndrimi dhe leje unike, procedurave të miratimit për punësim dhe deklaramit për punësim.

3. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale të shtetasve të huaj, kryhet vetëm nga personat e autorizuar në autoritetet përgjegjëse, të listuara në pikën 1 të këtij urdhri.

4. Personat e autorizuar për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe ata që kanë akses në këto të dhëna, për shkak të detyrës, i nënshtrohen detyrimit të ruajtjes së konfidentalitetit dhe mospërhapjes së asnjë të dhëne personale, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj.

5. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale të kryhet vetëm për qëllime legjitime të përcaktuara qartë, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

6. Të dhënat duhet të mbahen dhe të arkivohen në formë shkresore dhe elektronike, dokumentacioni i të cilave do të ruhet nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, sipas afateve më poshtë:

a) për një periudhë 5-vjeçare pas skadimit të vlefshmërisë së vizës ose të lejes së përkohshme të qëndrimit;

b) për një periudhë 10-vjeçare nga përfundimi i procedurës ndëshkuese administrative ose penale;

c) për personat e shpallur si të padëshiruar për një periudhë më shumë se dhjetë vjet, afat i ruajtjes së të dhënave është i njëjtë me atë të përcaktuar në urdhrin me të cilin i huaji është shpallur person i padëshiruar.

7. Të dhënat e arkivuara nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e mbledhjes dhe të përpunimit të tyre.

8. Në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të merren masa nga autoritetet shtetërore përgjegjëse për garantimin e sigurisë së të dhënave gjatë mbledhjes, përpunimit, evidentimit dhe fshirjes së tyre.

9. Autoritetet shtetërore përgjegjëse kryejnë mbledhjen, përpunimin, evidentimin dhe fshirjen e të dhënave personale për shtetasit e huaj, në përputhje edhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të miratuara sipas fushës së përgjegjësisë.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM  
**Bledar Çuçi**

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME  
**Olta Xhaçka**

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË  
**Delina Ibrahimaj**